

**KOMBET
E BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitet 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-T

Data: 15 dhjetor 2011

Origjinali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE II

Para: Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Kryegjykatës
Gjykatësit Burton Hall
Gjykatësit Guy Delvoie

Sekretari: Z. John Hocking

Vendim i datës: 15 dhjetor 2011

PROKURORI

kundër

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**VENDIM MBI MOCIONIN E PROKURORISË LIDHUR ME PËRKTHIMET NË
ANGLISHT TË PROVAVE MATERIALE QË LIDHEN ME DËSHMINË ME
SHKRIM TË BISLIM ZYRAPIT**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Paul Rogers

Avokatëve të të Akuzuarve

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen M. Rohan për Idriz Balajn
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

KJO DHOMË GJYQËSORE (“Dhoma”) e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej vitit 1991 (“Tribunali”);

PASI KA MARRË “Mocion lidhur me përkthimet në anglisht të provave materiale që lidhen me dëshminë me shkrim të Bislim Zyrapit”, dorëzuar publikisht prej Prokurorisë, së bashku me shtojcat publike A-D më 1 nëntor 2011 (“Mocioni”), ku Prokuroria kërkon leje për:

- zëvendësimin në sistemin elektronik të dokumentacionit gjyqësor të përkthimit në anglisht të Provës Materiale P190 me përkthimin zyrtar të Seksionit për Shërbime Gjuhësore dhe Konferenca (“CLSS”) pranuar si provë gjatë gjykimit të parë,¹
- zëvendësimin e përkthimeve të korrigjuara në anglisht të Provave Materiale P198 dhe P234 me përkthimet zyrtare të CLSS-së nga Shtojca C e Mocionit,² dhe
- ruajtjen e përkthimeve në anglisht të pranuar, të korrigjuara prej CLSS-së të Provave Materiale P178, P180, P191, P205, P208, P225, P227, P231, P243, P256, P261, P263, P267, P268 dhe P269;³

DUKE MARRË SHËNIM parashtimin e Prokurorisë se megjithëse përkthimet në anglisht të Provave Materiale P193 dhe P262 të pranuar gjatë rigjykimit ndryshojnë nga ato të gjykimit të parë, ajo nuk kundërshton zëvendësimin e përkthimeve në anglisht të Provave materiale P193 dhe P262 të dorëzuara gjatë këtij gjyqi me versionet e përdorura në gjykimin e parë duke qenë se, për mendimin e Prokurorisë, ato nuk përmbajnë gabime problematike përkthimi;⁴

¹ Mocion, para. 3, 9, 12.

² Mocioni, para. 2, 4, 12. Gabimet në përkthimin e përdorur gjatë gjykimit të parë janë paraqitur në Shtojcën B të Mocionit.

³ Mocioni, para. 2, 5, 12.

⁴ Mocioni, para 3, 10.

DUKE MARRË SHËNIM njoftimin e Prokurorisë se gjatë gjykimit të parë, përkthimet e Provave Materiale P177, P179, P202, P228 dhe P265 nuk janë vendosur në sistemin elektronik të dokumentacionit gjyqësor dhe për këtë arsye ajo tani ka vendosur në sistem përkthimet zyrtare të CLSS-së të të gjitha dokumenteve, me përjashtim të Provës Materiale P228, e cila nuk ka përkthim zyrtar të CLSS-së, dhe në lidhje me të propozon sigurimin e përkthimit zyrtar prej CLSS-së;⁵

DUKE MARRË SHËNIM “Përgjigje e Idriz Balajt ndaj Mocionit të Prokurorisë lidhur me përkthimet në anglisht të provave materiale që lidhen me dëshminë me shkrim të Bislim Zyrapit”, dorëzuar publikisht më 14 dhjetor 2011 (“Përgjigje e Balajt”), në të cilën Balajt:

- nuk kundërshton korrigjimin prej Prokurorisë të gabimeve në përkthimet e dokumenteve të përmendura në Mocion,⁶
- i kërkon Dhomës që të urdhërojë Prokurorinë të dorëzojë si provë përkthimet origjinale vetëm me korrigjimet e gabimeve të identifikuar,⁷
- i kërkon Dhomës që ta lejojë Prokurorinë të zëvendësojë përkthimin e korrigjuar të Provës Materiale P190 me përkthimin e përdorur gjatë gjykimit të parë,⁸ dhe
- i kërkon Dhomës që të urdhërojë Prokurorinë të përdorë përkthimet origjinale të Provave P193 dhe P262;⁹

DUKE MARRË SHËNIM “Kërkesë e Prokurorisë për leje për kundërpërgjigje dhe Kundërpërgjigje Përgjigjes së Balajt ndaj ‘Mocionit të Prokurorisë lidhur me përkthimet në anglisht të provave materiale që lidhen me dëshminë me shkrim të Bislim Zyrapit’” dorëzuar publikisht më 18 nëntor 2011 (“Kundërpërgjigje”), ku Prokuroria kërkon leje

⁵ Mocioni, para. 11.

⁶ Përgjigje e Balajt, para. 2, 19.

⁷ Përgjigje e Balajt, para. 16-17, 19.

⁸ Përgjigje e Balajt, para. 18-19.

⁹ Përgjigje e Balajt, para. 19.

për t'u kundërpërgjigjur përgjigjes së Balajt dhe kërkon që Dhoma të miratojë lejen e kërkuar në Mocion;¹⁰

DUKE MARRË SHËNIM parashtrimin e Prokurorisë, të pranuar nga Dhoma, se përkthimet e Provave materiale P198 dhe P234 të përdorura gjatë gjyqimit të parë përmbajnë gabime të identifikuar në Shtojcën B të Mocionit, se këto gabime u korrigjuan në përkthimet e pranuar gjatë rigjyqimit të cilat, megjithatë, nuk janë përkthime zyrtare të CLSS-së, dhe se tani Prokuroria dorëzon përkthimet zyrtare të CLSS-së në Shtojcën C të Mocionit;¹¹

DUKE MARRË SHËNIM parashtrimin e Prokurorisë të pranuar nga Dhoma që përkthimet në anglisht të Provave materiale P178, P180, P191, P205, P208, P225, P227, P231, P243, P256, P261, P263, P267, P268 dhe P269 të përdorura në gjykimin e parë përmbajnë gabime të paraqitura në Shtojcën D të Mocionit, dhe se versionet e korrigjuara të CLSS-së u dorëzuan gjatë rigjyqimit;¹²

DUKE MARRË SHËNIM parashtrimin e Prokurorisë se gjatë rigjyqimit vendosi pa dashje në sistemin elektronik të dokumentacionit gjyqësor përkthimin e pakorrigjuar dhe me gabime të Provës Materiale P190 që më vonë u pranua si provë, ndërkohë që përkthimi i CLSS-së i përdorur në gjykimin e parë ishte i saktë;¹³

DUKE MARRË SHËNIM njoftimin e Prokurorisë se gjatë gjyqimit të parë nuk u paraqitën përkthimet në anglisht të Provave Materiale P177, P179, P202, P228 dhe P265, se para se t'i paraqiste këto dokumente si prova materiale në rigjykim, Prokuroria i vendosi në sistemin elektronik të dokumentacionit gjyqësor përkthimet e tyre në anglisht, që të gjitha përkthime zyrtare të CLSS-së, me përjashtim të përkthimit të Provës materiale P228;¹⁴

¹⁰ Kundërpërgjigje, para. 1, 7.

¹¹ Mocioni, para. 4.

¹² Mocioni, para. 5.

¹³ Mocioni, para. 3, 9. Gabimet në përkthimin e përdorur gjatë rigjyqimit janë paraqitur në Shtojcën B të Mocionit.

¹⁴ Mocioni, para. 11.

DUKE MARRË SHËNIM se Balaj pajtohet që gabimet në përkthimet në anglisht të provave të përmendura në paragrafët 4 dhe 5 të Mocionit duhen korrigjuar;¹⁵

DUKE MARRË SHËNIM se gjithsesi Balaj kundërshton paraqitjen e njëanshme prej Prokurorisë të përkthimeve të reja dhe parashtrohet se kjo do të ndryshonte padrejtësisht dokumentacionin gjyqësor të gjykimit të parë duke qenë se dëshmia e Bislim Zyrapit dhe provat shoqëruese nga gjykimi i parë u pranuan në përputhje me Rregullën 92^{ter} në këtë rigjykim;¹⁶

DUKE MARRË SHËNIM propozimin e mëtejshëm të Balajt për paraqitjen e përkthimeve në anglisht të përdorura gjatë gjykimit të parë së bashku me “ndryshimet” e sugjeruara të përkthimit, apo që Prokuroria të dorëzojë përkthimet e para me ndryshimet e vetëm atyre pjesëve ku janë identifikuar gabimet;¹⁷

DUKE MARRË SHËNIM argumentin e Prokurorisë në Kundërpërgjigjen e saj se është i pabazë shqetësimi i Balajt se përdorimi i përkthimeve të reja përbën ndryshim të dokumentacionit gjyqësor, duke qenë se nga të gjitha provat materiale të përmendura në Mocion dhe për të cilat Prokuroria kërkon që në rigjykim të përdoren përkthimet e korrigjuara të CLSS-së, gjatë dëshmisë së tij dhënë në gjykimin e parë, Bislim Zyrapit komentoj vetëm Provën materiale P191, dhe komentet në lidhje me provat e tjera materiale ai i bëri në deklaratën e tij me shkrim të pranuar gjatë gjykimit të parë;¹⁸

DUKE MARRË MË TEJ SHËNIM se Balaj nuk vë në dukje ndonjë shembull konkret ku përdorimi i përkthimeve të korrigjuara në anglisht do të kishte për pasojë mospërputhje problematike me dokumentacionin gjyqësor të gjykimit të parë;

DUKE MARRË SHËNIM parashttrimin e Prokurorisë se Dhoma e ka bërë të qartë se preferon që përkthimet të rishikohen prej CLSS-së, dhe se dorëzimi i përkthimeve të

¹⁵ Përgjigje e Balajt, para. 2, 10-11, 18-19.

¹⁶ Përgjigje e Balajt, para. 13-15.

¹⁷ Përgjigje e Balajt, para. 6, 16-17.

¹⁸ Kundërpërgjigje, para. 3-4.

korrigjuara të dokumenteve të plota, në ndryshim nga zgjidhjet që sugjeron Balaj, vetëm mund të ndikojë pozitivisht në saktësinë e përkthimeve në rast të zbulimit të mangësive të tjera;¹⁹

DUKE MARRË PARASYSH se Prokuroria nuk bën të ditur nëse përkthimet në anglisht të Provave materiale P193 dhe P262 që ka ndërmend t'i përdorë janë përkthime zyrtare të CLSS-së, dhe se, përveç se në rrethana të jashtëzakonshme, përdoren vetëm përkthimet zyrtare të CLSS-së;²⁰

DUKE MARRË PARASYSH se mospërputhjet midis përkthimeve të ndryshme nuk janë domethënëse;

DUKE MARRË PARASYSH se përkthimi i parë i Provës materiale P191 u përdor në gjykimin e parë të çështjes *Haradinaj*, dhe se për hir të qartësisë së dokumentacionit gjyqësor është e përshtatshme që përveç përkthimit zyrtar të CLSS-së të Provës materiale P191 të ruhet edhe përkthimi në anglisht i këtij dokumenti, i përdorur në gjykimin e parë;

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA:

NË PËRPUTHJE ME Rregullat 54 dhe 126bis të Rregullores së Procedurës dhe Provave;

E LEJON Prokurorinë të paraqesë kundërpërgjigje dhe mban shënim përmbajtjen e kundërpërgjigjes;

MIRATON Mocionin **PJESËRISHT**, për sa vijon

E LEJON Prokurorinë të zëvendësojë përkthimin në anglisht të Provës materiale P190 me versionin e paraqitur në gjykimin e parë;

¹⁹ Kundërpërgjigje, para. 5-6.

²⁰ Mocioni, para, 2-3, 10-11.

E LEJON Prokurorinë të zëvendësojë përkthimet në anglisht të Provave materiale P198 dhe P234 me versionet e CLSS-së, siç bëhet e ditur në Shtojcën C të Mocionit; dhe

E LEJON Prokurorinë të mbajë përkthimet e paraqitura të korrigjuara të Provave Materiale P178, P180, P205, P208, P225, P227, P231, P243, P256, P261, P263, P267, P268 dhe P269;

E LEJON Prokurorinë të vendosë në sistemin elektronik të dokumentacionit gjyqësor përkthimet zyrtare të CLSS-së të Provave Materiale P177, P179, P202 dhe P265;

URDHËRON Prokurorinë të vendosë në sistemin elektronik të dokumentacionit gjyqësor përkthimin në anglisht të Provës materiale P191 të përdorur gjatë gjykimit të parë të çështjes *Haradinaj* dhe t'ia bashkëlidhë këtë përkthim kësaj Prove duke e ruajtur njëkohësisht përkthimin zyrtar të CLSS-së të këtij dokumenti;

URDHËRON Prokurorinë të sigurojë dhe vendosë në sistemin elektronik të dokumentacionit gjyqësor përkthimin zyrtar të CLSS-së të Provës materiale P228.

URDHËRON Prokurorinë që brenda 14 ditësh nga data e këtij Vendimi të njoftojë Dhomën nëse përkthimet në anglisht të Provave materiale P193 dhe P262 aktualisht të vendosura në sistemin elektronik të dokumentacionit gjyqësorë, janë përkthime zyrtare të CLSS-së.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/

Gjykatësi Bakone Justice Moloto
Kryegjykatës

Sot, më 15 dhjetor 2011.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]